REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. 14, Date 10/02/2026

"PËR MIRATIMIN TË LISTËS TË FAMILJEVE PËRFITUESE NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT SOCIAL "PËRMIRËSIM I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neneve 41, 42 dhe 43 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, vendimin nr. 454, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", si dhe në vijim VKB Nr. 102 datë 26.12.2025"Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Devoll", shkresa Nr. 628/2 Prot. datë 23.01.2026 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Inovacionit "Mbi fondet për programin e strehimit për vitin 2026".

PROPOZOJ:

1.Miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për programin e strehimit "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete e varfëra dhe të pafavorizuara" (bashkëlidhur këtij Projekt-vendimi).

2. Kjo listë me familjet përfituese u hartua pas verifikimit dhe kontrollit në ndërtesa të kushteve të banimit të familjeve aplikuese që jetojnë në territorin e Bashkisë Devoll, nga punonjësit e Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në përputhje me kriteret dhe kuadrin rregullator në fuqi mbi Strehimin Social.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Konceptoi: Pergjegjese e Sektorit te Kujdesit Social
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi Bazen Ligjore: Pergjegjese e Sektorit të Shërbimeve Juridike
Eriksela Avdo
Konfirmoi: Sekretar I Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 97, E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. 549 **Prot** **Bilisht më,** 11 .02.**2026**

RELACION

Nr.__, Date ___/___/2026

"PËR MIRATIMIN TË LISTËS TË FAMILJEVE PËRFITUESE NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT SOCIAL "PËRMIRËSIM I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA"

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 8 pika 2 i cili shprehimisht thotë:
Organet e njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë kopetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave
- neni 9 pika 1.1/a dhe 1.1/5 i cili shprehimisht thotë:
Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes sipas së cilës:

a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave:

1. 1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës: a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;

Neni 30 pika 7 i cili shprehimisht thotë:
Të drejtën e bashkëpunimit sipas se cilës:

a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund te ushtrojnë së bashku çdo funkion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të vecanta njëra – tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë.

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neneve 41, 42 dhe 43 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, vendimin nr. 454, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", si dhe në vijim VKB Nr. 102 datë 26.12.2025"Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Devoll", shkresa Nr. 628/2 Prot. datë 23.01.2026 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Inovacionit "Mbi fondet për programin e strehimit për vitin 2026".

Programi i strehimit social "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", është një instrument që ndihmon indivitet/familjet të cilët për shkak të pamundësisë ekonomike e kanë të vështirë të përmirësojnë kushtet e banimit. Zbatimi i projektit "Përmirësimi i kushteve të banimit" do të kryhet në bashkëfinancim me fonde të siguruara nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit bazuar në kufijtë e financimit sipas Udhëzimit Nr.31 datë 18.11.2019 "Për proçedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit". Referuar shkesës së ministrisë së ekonomisë dhe inovacionit Nr. 628/2 Prot. datë 23.01.2026 "Mbi fondet për programit e strehimit për vitin 2026" tabela nr. 1 "mbi nivelin e të ardhurave vjetore për frymë për cdo bashki për vitin 2024 e rendit Bashkinë Devoll në kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurve për frymë në masën 70 % dhe për financimin nga të ardhurat e bashkëfinancimit nga Bashkia Devoll në masën 30 %.
Lista e familjeve përfituese referuar është përzgjedhur pas aplikimeve që kanë bërë qytetarët në sistemin on-line të strehimit nëpërmjet portalit unik qeveritar E-Albania për të përfituar nga programet i strehimit social duke u bazuar edhe në kriteret që përcakton ligji i strehimit.

Neni 40
Kuptimi dhe qëllimi

1. Programi për përshtatjen e objekteve, pronë shtetërore, nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit, për t'i kthyer ato në banesa, me qëllim strehimin. Objektet e kthyera në fond banese sipas këtij neni qëndrojnë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përdoren për programin e banesave sociale sipas shkronjës "c" të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.
2. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për këtë qëllim.
3. Shfuqizuar.

Neni 41
Objektet/banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve

1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve, janë:
a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 42

Instrumentet e programit të kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese

1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:

a) përmirësimin e zonave të papërshtatshme sipas përcaktimit në pikën 52 të nenit 2 të këtij ligji;

b) përshtatjen e objekteve shtetërore të dala jashtë funksionit, me kusht që kostoja për metër katror për realizimin e investimit për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku realizohet investimi të mos jetë më e lartë se 80% e kostos së ndërtimit, të miratuar sipas shkronjës "dh" të nenit 72 të këtij ligji;

c) përmirësimin e banesave të amortizuara dhe atyre në rrezik shembjeje, me kushtin që kostot e përmirësimit të mos jenë më të larta se 70% e kostos së ndërtimit të një objekti të ri, sipas normave të strehimit.

2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kufijtë e financimit për çdo projekt individual dhe masa e granteve për çdo familje përcaktohen në termat e referencës, që miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për strehimin çdo vit para shpalljes së garës për grantin konkurrues.

Neni 43

Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit

1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:

a) personat me aftësi të kufizuara;

b) individët me statusin e jetimit;

c) familjet e policëve të rënë në detyrë;

ç) të moshuarit;

d) komuniteti rom;

dh) komuniteti egjiptian;

e) komunitetet e zonave rurale;

ë) prindërit e vetëm;

f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;

g) viktima të dhunës në familje.

Bashkangjitur po ju dërgojmë listën emerore të familjeve përfituese për programin "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" bashkëlidhur këtij relacioni.

Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
Marilda Bejleri

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/